Mbështetur në nenin 44, pika 4, të ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, të ndryshuar, të kreut I, neni 22 pika 4, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, komisioni i deklasifikimit dhe zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 21, datë 06.02.2023, të Kryetarit të Autoritetit “Për krijimin e komisionit të deklasifikimit dhe zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH”, i ndryshuar me urdhrin nr. 56, datë 23.03.2023 “Për një ndryshim në urdhrin nr. 21, datë 06.02.2023 “Për krijimin e komisionit të deklasifikimit dhe zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, me Vendimin nr.26, datë 20.08.2024 si më poshtë:

I. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. Arkivi i Autoritetit, fondi dega e Punëve të Brendshme Ersekë, kartelë model 2 nr. 2509 "Zemra", në ngarkim të Q.M.Xh., me 1 (një) fletë. Kartela daton në vitet 1953–1986. Niveli i klasifikimit të Kartelës është "sekret".
2. Arkivi i Autoritetit, fondi dega e Punëve të Brendshme Ersekë, dosje personale dhe Pune nr. 110 "Shkoza", në ngarkim të M.(M.) H.O., me 131 (njëqind e tridhjetë e një) fletë në total. Dosja daton në vitet 1950–1978. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
3. Arkivi i Autoritetit, fondi i veçantë, dosje personale dhe pune nr. 6441 "Ostreni", në ngarkim të F.Sh.Gj., me 158 (njëqind e pesëdhjetë e tetë) fletë në total. Dosja daton në vitet 1981–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
4. Arkivi i Autoritetit, fondi i veçantë, fashikull dhe dosje pune nr. 970 "Muratori", në ngarkim të R. H. H., me 239 (dyqind e tridhjetë e nëntë) fletë në total. Dosja daton në vitet 1976–1987. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
5. Arkivi i Autoritetit, fondi dega e Punëve të Brendshme Shkodër, dosje personale dhe pune nr. 3602 "Tigri", në ngarkim M.F.L.(B.), me 69 (gjashtëdhjetë e nëntë) fletë në total. Dosja daton në vitet 1971–1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është "sekret".
6. Arkivi i Autoritetit, fondi dega e Punëve të Brendshme Shkodër, dosje personale dhe pune nr. 298 "Besniku", në ngarkim të Rr.N.L., me 361 (treqind e gjashtëdhjetë e një) fletë në total. Dosja daton në vitet 1954–1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
7. Arkivi i Autoritetit, fondi dega e Punëve të Brendshme Krujë, dosje personale nr. 2242 "Sharri", në ngarkim të K.R.B., me 55 (pesëdhjetë e pesë) fletë. Dosja daton në vitet 1979–1987. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
8. Arkivi i Autoritetit, Fondi Ushtria, dosje personale dhe Pune nr. 1272 "Shigjeta", në ngarkim të Th.H.C., me 45 (dyzet e pesë) fletë në total. Dosja daton në vitet 1969–1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
9. Arkivi i Autoritetit, Fondi Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë, dosje personale dhe pune nr. 9857 "Tanku", në ngarkim të V.Z.Sh., me 17 (shtatëmbëdhjetë) fletë në total. Dosja daton në vitet 1976–1983. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
10. Arkivi i Autoritetit, Fondi Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë, dosje personale dhe pune nr. 9428 "Fizika", në ngarkim të A. Ll. S., me 13 (trembëdhjetë) fletë në total. Dosja daton në vitet 1976–1977. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
11. Arkivi i Autoritetit, Fondi Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë, Evidencë agjenturale operative e punëtorit operativ, me 284 (dyqind e tetëdhjetë e katër) fletë. Evidenca daton në vitin 1980. Niveli i klasifikimit të evidencës është "sekret".
12. Arkivi i Autoritetit, fondi dega e Punëve të Brendshme Vlorë, dosje personale dhe pune nr. 5455 "Sinjali", në ngarkim të B.D.K., me 50 (pesëdhjetë) fletë në total. Dosja daton në vitet 1976–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
13. Arkivi i Autoritetit, Fondi Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë, dosje personale nr. 14579 "Gramozi", në ngarkim të E.N.M.(Q.), me 30 (tridhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1987–1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
14. Arkivi i Autoritetit, Fondi Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë, dosje personale nr. 11922 "Fonditori", në ngarkim të M.S.L., me 47 (dyzet e shtatë) fletë. Dosja daton në vitet 1987–1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është "sekret".
15. Arkivi i Autoritetit, fondi dega e Punëve të Brendshme Dibër, dosje personale dhe pune nr. 4366 "Shpati", në ngarkim të S. Q. K., me 76 (shtatëdhjetë e gjashtë) fletë në total. Dosja daton në vitet 1986–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
16. Arkivi i Autoritetit, fondi dega e Punëve të Brendshme Vlorë, dosje personale dhe pune nr. 7299 "Sorkadhja" – "Delfini", në ngarkim të B. A. Sh., me 364 (treqind e gjashtëdhjetë e katër) fletë në total. Dosja daton në vitet 1986–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
17. Arkivi i Autoritetit, fondi dega IV, kartelë model 2 nr. 7508 "I Lumturi", në ngarkim të L.M.J., me 1 (një) fletë. Kartela daton në vitet 1987–1991. Niveli i klasifikimit të Kartelës është "sekret".
18. Arkivi i Autoritetit, Fondi Ushtria, dosje personale dhe pune nr. 13111 "Luani", në ngarkim të B.K.K., me 100 (njëqind) fletë në total. Dosja daton në vitet 1983–1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
19. Arkivi i Autoritetit, Fondi Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë, dosje personale dhe Pune nr. 15823 "Thupra", në ngarkim të P.K.L., me 30 (tridhjetë) fletë në total. Dosja daton në vitet 1989–1990. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
20. Arkivi i Autoritetit, Fondi Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë, dosje personale dhe Pune nr. 15219 "Studenti", në ngarkim të V.L.R., me 73 (shtatëdhjetë e tre) fletë në total. Dosja daton në vitet 1988–1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është "sekret".
21. Arkivi i Autoritetit, Fondi Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë, dosje personale dhe Pune nr. 14318 "Shega", në ngarkim të A.Q.B., me 60 (gjashtëdhjetë) fletë në total. Dosja daton në vitet 1986–1988. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
22. Arkivi i Autoritetit, Fondi nr. 141 Dega e Punëve të Brendshme Lushnjë, dosje personale nr. 3178 "Plepi", në ngarkim të A.K.Ll., me 19 (nëntëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1983–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është "tepër sekret".
23. Arkivi i Autoritetit, Fondi nr. 141, Dega e Punëve të Brendshme Lushnjë, Kartelë Model 2 nr. 4064 "Filmi", në ngarkim të L.D.S., me 1 (një) fletë. Kartela daton në vitet 1987–1988. Niveli i klasifikimit të Kartelës është "sekret".
24. Arkivi i Autoritetit, Fondi nr. 141, Dega e Punëve të Brendshme Lushnjë, Kartelë Model 2 nr. 4141 "Llampa", në ngarkim të Q.J.G., me 1 (një) fletë. Kartela daton në vitet 1987–1991. Niveli i klasifikimit të Kartelës është "sekret".

25. Arkivi i Autoritetit, fondi dega e Punëve të Brendshme Krujë, dosje personale dhe pune nr. 1868 “Pasqyra”, në ngarkim të M.F.Z., me 202 (dyqind e dy) fletë në total. Dosja daton në vitet 1970–1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
26. Arkivi i Autoritetit, fondi dega e Punëve të Brendshme Korçë, dosje përpunimi nr. 4802, në ngarkim të Q.Sh.H., me 199 (njëqind e nëntëdhjetë e nëntë) fletë. Dosja daton në vitet 1960–1988. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
27. Arkivi i Autoritetit, fondi dega e Punëve të Brendshme Korçë, dosje personale dhe pune nr. 5174 “Drita”, në ngarkim të M.S.B., me 116 (njëqind e gjashtëmbëdhjetë) fletë në total. Dosja daton në vitet 1975–1987. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
28. Arkivi i Autoritetit, fondi dega e Punëve të Brendshme Korçë, dosje personale dhe pune nr. 5153 “Studenti”, në ngarkim të V.I.K., me 86 (tetëdhjetë e gjashtë) fletë në total. Dosja daton në vitet 1971–1985. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.

KRYETARI I KDZH
Dr. Gentiana Sula

Vendim nr. 27, datë 27.08.2024 (i shkurtuar)

Mbështetur në nenin 44, pika 4, të ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, të ndryshuar, të kreut I, neni 22 pika 4, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, komisioni i deklasifikimit dhe zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 21, datë 06.02.2023, të Kryetarit të Autoritetit “Për krijimin e komisionit të deklasifikimit dhe zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror” në AIDSSH”, i ndryshuar me urdhrin nr. 56, datë 23.03.2023 “Për një ndryshim në urdhrin nr. 21, datë 06.02.2023 “Për krijimin e komisionit të deklasifikimit dhe zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, me Vendimin nr.27, datë 27.08.2024 si më poshtë:

- I. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:
 1. Arkivi i Autoritetit, Fondi të Arratisurve, fashikull nr. 199/9, në ngarkim të B.F., me 5 (pesë) fletë. Dosja daton në vitet 1971-1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
 2. Arkivi i Autoritetit, Fondi të Arratisurve, fashikull nr. 199/7, në ngarkim të B.F., me 245 (dyqind e dyzet e pesë) fletë. Dosja daton në vitet 1967-1984. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
 3. Arkivi i Autoritetit, Fondi të Arratisurve, dosje formulare nr. 117, në ngarkim të B.Ç., me 8 (tetë) fletë. Dosja daton në vitet 1944-1958. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
 4. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, dosja nr.22, bashkëpunimi dhe koordinimi i punës agenturale operativ ndërmjet organeve të sigurimit të shtetit të policisë e kufirit, me 12 (dymbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1973- 1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
 5. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, dosja nr.8, studimi bashkëpunimi e bashkërendimi i masave midis organeve të Sigurimit të policisë e të kufirit për zbulimin e parandalimin në kohë të veprimtarisë armiqësore të tradhtisë ndaj atdheut në formën e arratisjes jashtë shtetit, me 51 (pesëdhjetë e një) fletë. Dosja daton në vitin 1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
 6. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, dosja nr.19, përshkrim për shkaqet e arratisjes të dy personave në Jugosllavi, me 6 (gjashtë) fletë. Dosja daton në vitin 1983. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
 7. Arkivi i Autoritetit, Fondi Instituti, dosja nr.16, mbi veçoritë e punës së organeve të Sigurimit të Shtetit, me 16 (gjashtëmbëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1980-1982. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
 8. Arkivi i Autoritetit, Fondi Drejtoria e II, dosja pa numër, fashikuj me proces-verbale të thyesve të kufirit, me 254 (dyqind e pesëdhjetë e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1951-1957. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.

KRYETARI I KDZH
Dr. Gentiana Sula

Vendim nr. 28, datë 27.08.2024 (i shkurtuar)

Mbështetur në nenin 44, pika 4, të ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish - Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, të ndryshuar, të kreut I, neni 22 pika 4, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, komisioni i deklasifikimit dhe zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 21, datë 06.02.2023, të Kryetarit të Autoritetit “Për krijimin e komisionit të deklasifikimit dhe zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar “sekret

shtetëror” në AIDSSH”, i ndryshuar me urdhrin nr. 56, datë 23.03.2023 “Për një ndryshim në urdhrin nr. 21, datë 06.02.2023 “Për krijimin e komisionit të deklasifikimit dhe zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, me Vendimin nr.28, datë 27.08.2024 si më poshtë:

I. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. Arkivi i Autoritetit, fondi dega IV, dosar i kuq, Dosje me informacione për thyesat e kufirit, me 2 volume, në total me 844 (tetëqind e dyzet e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1982-1984. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
2. Arkivi i Autoritetit, fondi dega e Punëve të Brendshme Vlorë, Dosje pune dhe personale nr. 1265, “Bleta”, në ngarkim të K.F., me 436 (katërqind e tridhjetë e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitet 1972-1980. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
3. Arkivi i Autoritetit, fondi dega e Punëve të Brendshme Shkodër, dosje formulare nr. 3397, në ngarkim të Z.H., me 13 (trembëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitet 1978-1991. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
4. Arkivi i Autoritetit, fondi dega IV, dosar i verdhë, Dosje me informacione për thyesat e kufirit, me 804 (tetëqind e katër) fletë. Dosja daton në vitet 1982-1984. Niveli i klasifikimit të dosjes është “sekret”.
5. Arkivi i Autoritetit, fondi dega IV, Fashikull i thyesit të kufirit A.I., me 41 (dyzet e një) fletë. Dosja daton në vitin 1982. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
6. Arkivi i Autoritetit, fondi dega IV, Fashikull i thyesit të kufirit K.E., me 46 (dyzet e gjashtë) fletë. Dosja daton në vitin 1982. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
7. Arkivi i Autoritetit, Fondi Kosova, Dosja nr.4475, në ngarkim të M.H., me 42 (dyzet e dy) fletë. Dosja daton në vitin 1945-1965. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.
8. Arkivi i Autoritetit, Fondi të Arratisur, dosje formulare nr.480, në ngarkim të T.T., me 160 (njëqind e gjashtëdhjetë) fletë. Dosja daton në vitin 1951-1965. Niveli i klasifikimit të dosjes është “tepër sekret”.

KRYETARI I KDZH
Dr. Gentiana Sula



KUJTESA DHE EDUKIMI QYTETAR

ÇELET FONDI ARKIVOR I DEGËS SË SIGURIMIT TË NAFTËS AIDSSH simpozium mbi heronjtë e shkencës gjeologjike, viktima të regjimit

Tiranë 03.07.2024



Me zërin e bijve të inxhinierëve të naftës, heronj të shkencës dhe viktima të regjimit komunist, AIDSSH çeli fondin arkivor të Degës së Sigurimit Naftës dhe zhvilloi simpoziumin shkencor: “Eksplorimi dhe Zhvillimi i sektorit të naftës nën kontrollin e Sigurimit të Shtetit 1944-1991”, në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe të Energjisë dhe Fakultetin të Gjeologjisë dhe Minierave.

Studiues të historisë, ekonomisë dhe jurisprudencës, profesorë dhe inxhinierë të naftës, dëshmitarë të kohës, familjarë sollën fakte dhe studime që hodhën dritë mbi zhvillimin të sektorit të naftës në Shqipëri gjatë periudhës 1945 – 1991, dokumentimin e represionit të Partisë së Punës ndaj shkencës, fatin tragjik të gjeologëve e shkencëtarëve si: Stanislav Zuber, Riza Alizoti, Thoma Pojani, Filip Nashi, Beqir Alia, Koço Plaku, Protoko Murati, Milto Gjokopulli, Dhimitër Stefa, Jani Konomi dhe Nuredin Skrapari etj. Ata u akuzuan si sabotatorë të pushtetit, për agjitacion e propagandë dhe shkatërrim të pronës së përbashkët publike. Një pjesë e tyre u dënuan me vdekje dhe u pushkatuan dhe trupat e tyre janë ende sot të pagjetur.

Kryetarja e Autoritetit, Dr. Gentiana Sula tha se: “Diktatura pa dhunën, ideologjinë dhe politizimin ekstrem është e paqëndrueshme. Por dhe prodhimi, pa te drejtat njerëzore të stafit teknik rezultoi po ashtu i paqëndrueshëm. Nëpërmjet çeljes së arkivës dokumentare si dhe studimit të tyre nga ekspertë të historisë dhe shkencës së gjeologjisë japim sot një kontribut të pazëvendësueshëm në ndriçimin e skutave të errëta të Sigurimit të Shtetit, që me hetimet, persekutimet e ekzekutimet famëkeqe turpëruan çdo ndjenjë humane dhe futën në ngërç zhvillimin e sektorit të naftës në Shqipëri.”

Jovan Plaku, djali i inxhinierit të pushkatuar, Koço Plaku, ende sot i zhdukur tha se: “Sot, di të them që të gjitha këto dosje, kanë vlerë të mirëfilltë studimore, sepse ato zbulojnë jo vetëm shkallën e persekutimit, por zbulojnë në përmasë të plotë edhe djallëzinë dhe perversitetin e shërbëtorëve të regjimit në ekzekutimin e këtij persekutimi. Nuk kishte si të ndodhte ndryshe. Mizoria e diktaturës si regjim, mund të tejkalohet vetëm nga një mizori tjetër, mizoria e ekzekutorëve të regjimit, çnjerëzorë pa kufij dhe të pashtershëm në ligësi.”

Agim Gjokopulli, djali i inxhinierit Milto Gjokopulli, pushkatuar, ende i pagjetur tha se: “Shteti duhet të kërkonte ndjesën familjeve tona, ndjesë ndaj njerëzve të shkatërruar. Duhet të ishte shteti sot që të jepte llogari se ku janë. Kemi 34 vjet bashkë me Jovanin që kemi kërkuar privatisht, jemi gjykuar që kemi kërkuar privatisht. Jemi arrestuar se kemi kërkuar eshtërtat e prindërve tanë.»



Dr. Alda Biçoku, albanologe dhe e reja e Akademik Prof. Teki Biçokut përcolli fakte historike nga puna e akademikut dhe qëndresa e tij në burgje. Ai nuk pranoi të dilte dëshmitar në gjyqin e ministrit të tij, Koço Theodhosi. E izoluan 18 muaj dhe e dënuan me 20 vjet burg. Dëshmia e saj pasuron me fakte procesin e të pagjeturve, të vdekur në burgje: “Si shkrues për drejtuesit e burgut, Teki Biçoku regjistronte edhe emrat e atyre që vdisnin dhe fshehurazi u vendoste pranë trupit një shishe të vogël me emrat e tyre brenda saj. Kufomat e të burgosurve nuk u dorëzoheshin familjeve, sepse edhe të vdekur duhej t’i plotësonin në varrezat e burgut vitet e dënimit. Statistikat e sipërpërmendura dhe emrat e të vdekurve nëpër shishe u konsideruan si veprime të palejueshme, prandaj u dërgua në një burg tjetër.”

Kujtime të dhimbshme nga fëmijëria e saj solli edhe Kozeta Bushati, vajza e Beqir Alisë, dënuar në gjyqin ndaj inxhinierëve të naftës, kriza e indentitetit dhe nevoja për të kuptuar se cili ishte faji i babait i ndryshuan asaj jetën. Po kështu edhe Nezi Alizoti, e bija e inxhinierit Riza Alizoti, dënuar me varje në vitin 1947, kujtoi sakrificat e të atit për t’i shërbyer vendit



edhe pse me mundësi për vijuar karrierën në Angli ku kish kryer studimet.

Altin Hoxha, anëtar i AIDSSH-së në studimin e tij mbi statistikat e përndjekjes në sektorin e naftës solli fakte të panjohura më parë për publikun: “Përballja e parë e sigurimit të shtetit ishte me specialistët italianë të cilët mbetën në Shqipëri si ish punonjës të kompanive AIPA dhe AGIP që shfrytëzonin koncesionet e naftës në Shqipëri.

Më shumë se 50 specialistë italianë, të vendosur në Kuçovë dhe Tiranë do të ishin në optikën e Sigurimit të Shtetit dhe do të përballëshin me një urrejtje dhe përndjekje nga strukturat e sapodala nga lufta, që përfaqësonin Sigurimin e Shtetit. Një pjesë e tyre si inxhinierët e naftës Andrea Taraskoni dhe Mario Cetti do të ekzekutoheshin në vitin 1945, të tjerë si: Vicenzo Andrizoni, Vitorio Profili, Aldo Cavolini, Don Plestro Scavalini, Antonio Meneguni, Nicola Achile, Otavio Benetti, Lusi Maechisio u arrestuan dhe u burgosën.

Në vitin 1946 do të dënoheshin me vdekje si sabotatorë dhe tregti të paligjshme Profesor Venezio Lozi dhe Salvatore Gombia, me 101 vite burgim ing Ludoviko Petrasi me 20 vjet Albero Agostinone dhe me nga 10 vjet Antonio Demarkchis dhe Vicenzo Gallo. Arsyeya kryesore e dënimit ishte se tentuan të ktheheshin në vendin e tyre.”

Prof. Dr. Nevton Kodhelaj, Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave foli mbi zhvillimin e Sektorit të nxjerrjes dhe përpunimit të naftës dhe gazit në Shqipëri dhe dhunës së pushtetit mbi gjeologët.



Ilia Gjermani, përfaqësues i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjetikës në kumtesën e tij mbi kërkimi dhe prodhimin e hidrokarbureve në Shqipëri bëri një paraqitje mbi historikun e këtij aktiviteti.

Dr. Ermal Frashëri tha se: “Ky simpoziom shërben si një platformë për të vijuar studimet mbi sektorin e naftës, një nga mendimet që unë do sugjeroja është avancimi i kërkimeve mbi rolin që ka patur nafta në ekonominë shqiptare, mënyra si u formua ajo si industri sepse ka shumë për të mësuar nga kujtime të naftëtarëve të inxhinierëve, punëtorëve të sektorit dhe ka plot gjëra për të avancuar lidhur me mënyrën se si është qeverisur sektori naftës mënyra se si është ngritur ai si sektor.”

Gerla Kotka, nga AIDSSH në studimin e saj mbi persekutimin dhe dënimin e dy inxhinierëve të naftës: Koço Plaku dhe Milto Gjokopulli në dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit tha se: “Pavarësisht, kontributit të rëndësishëm të inxhinierëve në industrinë e naftës, ata morën dënimet më të larta dhe të padrejta nga sistemi, i cili në politikëbërjen e tij orientohej në gjetjen e armiqve në radhët e njerëzve më të përkushtuar të shkencës dhe studimit.”

Jonel Hibo, AIDSSH në kumtesën e tij mbi veprimtarinë e Stanislav Zuberit, Riza Alizotit, Lipe Nashit dhe Nuredin Skraparit, parë në Dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit dëshmoi mbi hetuesinë e përdorur ndaj tyre.

“Gjithë kjo dramë, gjithë ky kalvar vuajtjesh të pamërituara. ky potencial njerëzor i shkuar dëm nga 1947 deri në 1990 meriton një përmendore në Fier dhe ky është një projekt që duam ta vijojmë me Bashkinë e qytetit dhe Albeptrolin,”- tha në mbyllje të takimit kryetarja Sula.

AIDSSH NË RAPORTIN VJETOR 2023 NË PARLAMENT

Ekspozimi i të vërtetave historike, drejtësi për të zhdukurit, rishqyrtim dhe edukim

Tiranë, 18.07.2024



“Me hapjen e arkivës sekrete të diktaturës, njohim më mirë rrënjët tona dhe sfidojmë narrativat e vjetra dhe ecim drejt një të ardhme demokratike” deklaroi gjatë raportimit të veprimtarisë së AIDSSH për 2023, në seancën plenare që vijoi mëngjesin e 19 korrikut, kreu i institucionit, Dr. Gentiana Sula.

Modernizimi i arkivës, krijimi i Mediatekës, krijimi i fondeve rreth narrativave familjare, personale, të grupeve të targetuara; rishqyrtimi historik i policisë politike të Ish-Sigurimit të Shtetit; ekspozimi i të vërtetave historike, hetimet për të zhdukurit në diktaturë, edukimi përmes ekspozitave, simpoziumeve, aktiviteteve përkujtuese, publikimeve për të rritur dhe fëmijë me temë nga ngjarje të së kaluarës, ndërtimi i Platformës digjitale “Të mësojmë mbi të shkuarën - burime arsimore të hapura 1944-1991, bashkëpunimi me ISKK në fushën e studimit, ishin disa nga çështjet kryesore ku u përqendruar raportimi.

Sula theksoi se raporti dokumenton punën e kryer për t’i shërbyer rishqyrtimit historik të policisë politike si Ish-Sigurimi i Shtetit, sjelljen e narrativave të atyre që u targetuan si kundërshtarë apo armiq të kohës, “përmes përmirësimit të cilësisë dhe shpejtësisë në shërbimin e dokumenteve, bashkëpunimin e zgjeruar e të qëndrueshëm me institucione si brenda dhe jashtë vendit”.

Në lidhje me modernizimin e arkivës, AIDSSH është angazhuar për grumbullimin e vazhdueshëm të dokumentacionit arkivor dhe krijimin e arkivës digjitale të pagëzuar si “Mediatekë” me qëllim akses më të gjerë në dokumente. Ndërsa vijon grumbullimi i dokumentacionit të hartuar nga ish-Sigurimi i Shtetit nga institucionet e tjera.

Me ndryshimet ligjore, gjatë vitit të kaluar janë marrë 21 vendime të Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit 5 591 njësi arkivore (dosje, fashikuj etj.) prej 237 259 fletë dokumente arkivore brenda vitit, inventarët e të cilëve janë publikuar në fletoret zyrtare dhe buletinet e institucionit.

Janë dyfishuar dosjet fizike të digjitalizuara në krahasim me një vit më parë, 2113 dosje fizike nga 1019 në vitin 2022, 175 dosje të mikrofilmuara, me një total prej 158 268 faqe dokumente arkivore, si dhe ka nisur skanimit masiv i dokumenteve me afro 1.500.000 imazhe, kjo me kontraktim me palët e treta.

Gjatë vitit 2023 AIDSSH ka ofruar shërbimin e tij për individë, studiues dhe media duke regjistruar 457 kërkesa të reja individuale dhe 112 kërkesa studimore mediatike. Janë vënë në dispozicion 1329 dosje, me rreth 138 010 faqe, ndër të cilat rreth 10 522 faqe kanë kaluar në proces anonimizimi.

Puna e AIDSSH ka vijuar edhe në verifikimin e figurave ku janë gjatë vitit të kaluar janë verifikuar 257 kandidatë nga të cilët vetëm 14 prej tyre figurojnë në dokumente të Ish-Sigurimit të Shtetit. Janë paraqitur gjithashtu me iniciativë personale 4 kërkesa për verifikim nga deputetë në detyrë të Kuvendit të Shqipërisë. Për zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023, AIDSSH dërgoi shkresa pranë 50 subjekteve politike apo koalicioneve të regjistruara, por janë paraqitur vetëm 2 kërkesa një nga kandidati për Këshillin Bashkiak Vlorë dhe tjetra nga kandidati për Këshillin Bashkiak Krujë.

Kryetarja e AIDSSH-së theksoi se: “Vijon të mbetet problematikë mungesa e bashkëpunimit nga ana e subjekteve politike, që çon në moszbatim të detyrave ligjore të ngarkuara sipas përcaktimeve të nenit 30 të ligjit. Paketa me propozime e dorëzuar nga Autoriteti për ndryshime ligjore në Kodin Zgjedhor do të krijojë hapësirën ligjore që të kryhet verifikimi i gjithë kandidatëve që kandidojnë në zgjedhje.”

Lidhur me riverifikimin e figurave të zyrtarëve të pajisur më parë, me certifikatë pastërtie figure AIDSSH ka identifikuar 13 zyrtarë në 6 institucione:

1 kandidat i MEPI është liruar nga detyra për efekt të moshës së pensionit.

1 kandidat i KLGJ-së nuk është emëruar në ndonjë detyrë nga ana e KLGJ.

Për 4 kandidatët e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, dy prej tyre nuk janë më në Policinë e Shtetit, e dy zyrtarët e tjerë nuk janë subjekte verifikimi sipas ligjit nr. 12/2018.

Kandidati i Gjykatës së Rrethit Vlorë është skualifikuar nga vettingu ndërsa 2 institucione nuk kanë kthyer ende përgjigje zyrtare.

Ndryshim ligjor ka dhënë rezultat pasi në vitin 2023, për një kandidat të pajisur më parë me certifikatë pastërtie figure, i cili pas riverifikimeve figuroi në detyrën e prokurorit në një çështje penale politike. Gjithashtu, AIDSSH u investua për një raport mbi qasjen krahasuese të verifikimit të figurave mes komisioneve të mëparshme dhe të standardit të ligjit 45-15 dhe gjeti të dhëna të rëndësishme që informojnë trashëgiminë e Ish-Sigurimit të Shtetit në periudhën tranzitore, fakte të cilat janë bërë dhe publike, në formë statistike, për sa kohë ende dokumentet burimore që janë prodhuar nga SHISH janë të padeklasifikuara.

“Prandaj në këtë kuadër kërkojmë bashkëpunimin e forcave politike apo komisionit të reformës zgjedhore. Autoriteti përsëri ka paraqitur propozime për ndryshime ligjore në Kodin Zgjedhor që do të krijojnë hapësirën ligjore që lejojnë të kryhet verifikimi i të gjithë kandidatëve që kandidojnë në zgjedhje” tha kryetarja Sula.

Kreu i AIDSSH kërkoi bashkëpunim edhe nga pushteti vendor. “Sot ka një numër në rritje të bashkive (10) që bashkëpunojnë më AIDSSH për të verifikuar kandidatët për nderime e medalje. Po përsëri ky numër nuk është i plotë, “- tha Sula duke shtuar se janë verifikuar 40 kandidatë për tituj nderi dhe 10 prej tyre figuruan në arkivat e AIDSSH.

Gjatë vitit 2023 janë zhvilluar 3 hetime administrative për verifikimin e dyshimeve për vendvarrime të pashenjuara të mundshme dhe dy hetime administrative për verifikimin e vërtetësisë si dokumente arkivore. Gjithashtu janë depozituar 57 kërkesa, nga të afërm të personave të zhdukur, nga të cilat 39 rezultojnë me të dhëna arkivore, ndërsa 9 kërkesa pa të dhëna. Të tjerat janë në proces. Janë realizuar 3 hetime administrative mbi këtë temë, 6 inspektive në vendvarrime të dyshuara, shenjëzimi i një vendvarrimi në Shkodër pranë varrezave të Rrmajit.

Ka nisur gjithashtu edhe hetimi administrativ, me qëllim qartësimin e fatit, kërkimin, gjetjen, identifikimin dhe rikuperimin e eshtrave të personave të vdekur ose të zhdukur gjatë vuajtjes së dënimit në Burgun e Spaçit; lidhur me këtë është identifikuar vendvarrimi i mundshëm ku mund të jenë eshtrat e 4 të pushkatuarve të Revoltës së Spaçit, Skënder Daja, Pal Zefi, Dervish Bejko dhe Hajri Pashaj.

“Ndërkohë që kemi bërë qartësimin e fatit nuk po bëjmë hapa përpara për sa kohe pritet ende miratimi i VKM-së “Për gjetjen, identifikimin, rikuperimin e eshtrave dhe mënyrën e mbrojtjes e ruajtjes së vendvarrimeve të personave të zhdukur gjatë periudhës 29 nëntor 1944-2 korrik 1-1991, miratimi i hap rrugë procesit të gjurmëve dhe kam bindjen që përcillet nga mbarë shoqëria si arritje humane”. tha Sula.

Gjatë vitit të kaluar AIDSSH ka realizuar 49 aktivitete, konferenca dhe simpoziume dhe 50 botime të printuara dhe online, si dhe ka organizuar 4 ekspozita me burime arkivore duke përkujtuar ngjarje të rëndësishme për periudhën 1994-1991.

Në fushën e edukimit qytetar është konkretizuar me sukses bashkëpunimi zyrtar me MAS për përfshirjen në kurrikulën e arsimit parauniversitar të informimit mbi aktivitetin e ish-Sigurimit të Shtetit. Konceptimi dhe vënia në funksion e platformës “Mësojmë nga e kaluara, burime arsimore të hapura 1944-1991”, një platformë interaktive me burime parësore si arkiv, dëshmi gojore, etj., e cila po bën bashkë aktorët e kujtesës dhe ekspertët e arsimit, me qëllim edukimin për qytetari demokratike. Themelimi, në këtë kuadër i aktiviteteve periodike si Klubi Librit, Arkiva e Hapur, Dosja e Hapur, Leksione të Hapura, por edhe botime për arsimin parauniversitar janë një sërë hapash konkretë në misionin e AIDSSH-së për edukimin qytetar.

Së fundi në lidhje me vendet e kujtesës, puna AIDSSH-së gjatë vitit 2023 ka vijuar me planet për realizimin e një memoriali në Ersekë në nderim të të vrarëve dhe të zhdukurve në kufi, si dhe ndërtimit të një varreze monumentale në Tiranë për të zhdukurit nga diktatura, ekzekutuar apo vrarë e vdekur në situata të pahetuara në burgje, kampe, hetuesi, kufi. Ndërsa propozimet e Autoritetit në ligjin “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, për përfshirjen në ndërtimin e Muzeut Kombëtar “Kampi i punës së detyruar të të burgosurve Spaç” dhe Muzeu Kombëtar “Kampi i internimit me tela me gjemba Tepelenë”, ende nuk janë miratuar.

AIDSSH KUJTON VIKTIMAT PAFAJSHME “Porto Palermo tjetër - nga kamp, në përkujtim”



Porto Palermo 22.08.2024

Një dokument i Agjencisë Amerikane të Inteligjencës (CIA), (shkurt 1950), raporton për rrugëtimin në 20 janar të vitit 1950 të 14 makinave me persona të internuar, pjesëtarë të familjeve nacionaliste, nga burgu i Shkodrës drejt kalasë në Himarë. Të internuarit e rinj gjejnë aty të tjerë si ata, të transferuar nga kampi i internimit të Tepelenës. 75 vjet më parë në burgun e kësaj kalaje, përdorur më parë nga pushtimi fashist për kundërshtarët politikë, u mbyllën fëmijë, gra e pleq, dënuar pa proces, pa gjyq. Ata ishin viktimat e para të luftës tragjike të klasave që nisi në mbarim të Luftës së Dytë Botërore.

Në kuadër të Ditës Evropiane të Përkujtimit të Viktimave të Regjimeve Totalitare, e përcaktuar nga Parlamenti Evropian dhe Këshilli i Evropës, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Librit dhe Leximit dhe Bashkinë e Himarës, të mbijetuar e familjarë të tyre, nderuan vuajtjen e të miturve, grave, të rinjve, e të moshuarve pa faj që u internuan në Porto Palermo.

Ceremoninë e përkujtimit e përshëndeti Kryetarja e Kuvendit, Elisa Spiropali: “Ka vetëm 3 dekada e pak që Shqipëria u nda nga diktatura komuniste. Foshnjat e lindura në atë kufi thyerje të historisë tashmë janë prindër e prindërit e tyre janë gjyshër nipash e mbesash. Është shumë e vështirë t’i shpjegohet fëmijës së sotëm se çfarë ishte burgu i ndërgjegjes, se çfarë peshe kishte dera e qelisë, sa e errët ishte humbella e galerisë ku punohej skllavërisht, se çfarë makthi ishin telat me gjemba, apo sa vriste plumbi që qëllonte në emër të ideologjisë që ndau shqiptarin nga shqiptari, nënën nga biri, motrën nga vëllai, fqinjin nga fqinji me barriera frike e urrejtjeje, refuzimi e mohimi”.

“Jemi këtu për të kujtuar viktimat e dy ideologjive më të rrezikshme të shekullit XX, fashizmit dhe komunizmit të cilat shkaktuan shumë viktima të pafajshme. Ne synojmë të nderojmë historitë e njerëzve tanë që u detyruan me forcë të jetojnë në këto kampe dhe të parandalojmë që tragjedia e tyre të mohohet e harrohet. Përkujtimi është një akt jetik për të kuptuar pasojat e tyre tragjike të mekanizmave totalitare dhe për të ndërtuar shoqëri të drejta e paqësore në të ardhmen. Përmes përkujtimit ne frymëzojmë ndenjen e tolerancës në shoqëri, ndriçojmë skutat më të errëta të historisë, me



misionin për mbushur hendekun që kanë lënë pas lufta për pushtet dhe përplasjet ideologjike që vijnë ende në ditët tona, përmes mohimit të së vërtetës,” thanë në fjalën e saj kryetarja AIDSSH-së, Gentiana Sula.

Drejtoresha e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit, znj. Alda Bardhyli, iu bashkua misionit të AIDSSH-së përmes aktivitetit “Varg Festival”, ku aktorët Dritan Boriçi dhe Kudrejti Alikaj sollën poezitë e Luan Ramës mbi historinë e të internuarve në Porto Palermo, përmes një performancë artistike krijuar nga shkrimtarja Rovena Rrozhani me dëshmi të mbijetuarve të këtij kampi dhënë për institucionin.

Et’hem Fejzollari, kryetar i Shoqatës Antikomuniste e Ish-të Përndjekurve Politikë Demokratë të Shqipërisë tha ndër të tjera: «Unë isha 5 vjeç i internuar në Tepelenë dhe mund të



quaj me plot gojën që ajo që ndodhi me ne ishte gjenocid. Ne u ndëshkuam edhe pse ishim fëmijë. Njerëzit tanë vazhdojnë të vuajnë. Ata nuk i kanë gjetur ende eshtrat e shumë prej atyre që vdiqën në këtë kamp.»

Përfaqësuesi i Bashkisë së Himarës, Klajdi Mata dorëzoi çmimin e solidaritetit për familjet Mirakaj, Kaloshi, Ndreu, Mavrovo, Lolo, Kthupi, Capi, Çaushaj.

Dëshmitë e mbledhura nga AIDSSH të katër të dënuarve në Porto Palermo ndërsa ishin fëmijë, Lek Pervizi, Lek Mirakaj, Dine Dine, Mirakaj dhe Rudina (Dema) Mane sollën atmosferën e atyre viteve të ashpra.

Eventi u shoqërua me ekspozitën me piktura të Lek Pervizit ku janë përfshirë portrete të disa prej personave që kanë vuajtur dënimin në Kalanë e Porto Palermos, gjatë viteve 1949 -1950 kur kalaja shërbeu si kamp-burg për gra, burra e fëmijë. Ekspozita qëndroi e hapur për dy ditë.



Sipas dokumente arkivore, kampi i internimit që kish shërbyer deri në 1942 si burg për kundërshtarët e pushtimit fashizmit, u rihap shtatë vjet më vonë pas vendosjes së komunizmit në vend, për fëmijë, gra e pleq, pa proces, pa gjyq, por në bazë të një dënimi kolektiv si shfaqje e luftës tragjike të klasave.

Historia e kampit-burg të Porto Palermos është shumë pak e dokumentuar. Të dhënat e gjetura si: një fletë regjistri me statistikat e të internuarve (Arkivi i AIDSSH-së, Fondi nr. 4, dosje nr.70), pak rreshta në dosjet individuale të ish-të dënuarve dhe dëshmitë gojore të mbledhura nga të mbijetuarit të këtij kampi hedhin dritë mbi historinë e errët të ekzistencës së kampit çnjerëzor.

Në vijim të punës për zbardhjen e funksionimit dhe vuajtjeve në këtë kamp, Autoriteti në bashkëpunim me Bashkinë Himarë, synon të fusë në hartën e institucioneve të vuajtjes edhe burgun e kalasë së Porto Palermos, për të rrëfyer një kohë të gjatë shtypjeje dhe mbijetese, që zë fill në Luftën e Dytë Botërore dhe vijon me vendosjen e regjimit komunist.

“Ne synojmë që këto vende të kthehen në vende kujtese kur qytetarët dhe të rinjtë edukohen me ngjarje të së shkuarës dhe i kërkojmë Bashkisë, Këshillit Bashkiak që në këtë kala të vendoset një pllakë që kujton dhe nderon kujtimin e atyre që vuajtën në këto kamp,”- tha kryetarja e AIDSSH-s.

Çdo 23 gusht, Autoriteti bashkë me të mbijetuar dhe familjarë të tyre nderon vuajtjen e të miturve, grave e të moshuarve pa faj që u internuan në kampin e Tepelenës. Këtë herë u zgjodh Porto Palermo.



AIDSSH VENDOS KURORËN E PËRVITSHME TË NDERIMIT DHE PËRKUJTIMIT TË VIKTIMAVE

Tepelenë 23.08.2024

Nga kalaja e Porto-Palermo, ekipi i AIDSSH-s bashkë me të mbijetuar dhe familjarë të tyre që vuajtën në kampin e Tepelenës zhvilluan homazhe në përkujtim të të gjitha viktimave dhe atyre që i mbijetuan vuajtjeve dhe torturave të këtij kampi.

Pjesëmarrësit ndoqën rrugën që bënë të internuarit nga errësira e Kalasë në barakat e kampit ku uria dhe dizanteria u mori jetën 300 fëmijëve. Mes tyre ishte edhe Burbuqe Lamçe, e cila u internua 10 vjeçe në Tepelenë bashkë me familjen e saj. Ajo tregoi për jetën e tmerrshme në kamp, kujtoi familjet bashkëvuajtëse dhe vdekjen e fëmijëve, kujtoi urinë, dhe brutalitetin. Ndër të tjera tregoi për dënimin e përkohshëm në birucë të tre vajzave të vogla që u larguan nga kampi jashtë vëmendjes së rojeve.

Gjatë këtij aktiviteti, kryetarja e AIDSSH-s, Gentiana Sula dhe ish-vuajtës në kampin e Tepelenës vendosën kurorën e përvitshme të nderimit dhe përkujtimit të viktimave.



DITA NDËRKOMBËTARE E TË ZHDUKURVE AIDSSH MBAN SIMPOZIUMIN “NGA E KALUARA NË PËRKUJTIM - KUFIJTË E DIKTATURËS 1944-1991”

Pogradec, 28.08.2024

Kalimi i palejuar i kufirit në vitet 1944-1991, sfidat dhe pasojat e tij tek njerëzit që guxuan ta shkelnin atë, dokumentimi i motiveve, ndërtimi i profilit të shkelësit të kufirit, identifikimi i shtigjeve dhe kthimi i tyre në vende të kujtesës, janë disa sfida që i paraprijnë aksionit të AIDSSH për hetimin e vendvarrimeve të dyshuara, për trupat e atyre që nuk iu dorëzuan kurrë familjarëve.



Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të të Zhdukurve. AIDSSH në bashkëpunim me Shoqatën Antikomuniste të Ish-të Përndjekurve Politik Demokrat, Bashkinë Pogradec; Departamentin e Historisë (FHF); Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve, në Shkup; Institutin e Integritit dhe Ish-të Përndjekurve Politikë dhe ICMP-n (Komisionin Ndërkombëtar të të Pagjeturve) mbajti në datën 28 Gusht 2024 simpoziumin: “Nga e kaluara në përkujtim - Kufijtë e diktaturës 1944-1991”.

Takimi u hap nga Kryetarja e Autoritetit, Dr. Gentiana Sula e cila u shpreh se: “Kujt i refuzohet e drejta për t’u larguar – nga familja, nga komuniteti, – i mohohet esenca e vet njerëzore; nga ana tjetër, edhe të jetosh në vendin tënd është e drejtë themelore e njeriut. Sot kujtojmë ata që guxuan të thyejnë kufijtë dhe ata që paguan kosto të larta të lirisë për shkak të masave të ashpra çnjerëzore që përdori diktatura. Refuzimi i së drejtës për t’u larguar nga vendi është mohim i aspiratës për zhvillim e përparim, por ky refuzim për mijëra shqiptarë rezultoi ishte i ashpër, gati çnjerëzor. Rreth 13 600 persona u numëruan të arratisur në raportet e Sigurimit të Shtetit, nga 1944 deri në vitin 1990, pa llogaritur të larguarit e ambasadave në korrikun e ‘90-s. Nga këta, rreth 4 784 ishin gra e fëmijë. Dominonin të ikurit e viteve 1945 e 1948. 998 të tjerë vdiqën ose u vranë nga regjimi në përpjekjen për t’u larguar nga vendi. Familjet e të ikurve, të vuarëve në kufi u përdoqën duke e rritur edhe me tej rrethin e viktimave.

Ka disa arsye kryesore pse disa vende kufizojnë daljen e qytetarëve. Një nga ato është kontrolli politik. Qeveritë autoritare duan të mbajnë kontroll mbi popullsinë dhe të parandalojnë “largimin” e kundërshtarëve politikë. Ato frikësohen se qytetarët mund të dëmtojnë interesat e vendit nëse lejohen të udhëtojnë lirshëm.

Por ka edhe interesa ekonomike që kufizojnë lirinë e lëvizjes. Janë disa vende që duan të parandalojnë “rrjedhjen” e trurit dhe kapitalit njerëzor, duke kufizuar lëvizjen e qytetarëve. Ato mund të kenë frikë se qytetarët do të zgjedhin të largohen përgjithmonë.



Por shkaku më i qëndrueshëm i ndalimit të lëvizjes është ideologjia dhe propaganda. Qeveritë totalitare shpesh e paraqesin lëvizjen e kufizuar si “mbrojtje” ndaj ndikimeve të jashtme. Ato duan të mbajnë kontroll mbi narrativën kombëtare dhe të parandalojnë veprime kundërrevolucionare.

Shqipëria gjatë diktaturës i shkeli këto standarde ndërkombëtare, duke imponuar kufizime të ndryshme ndaj lëvizjeve të qytetarëve të tyre. Vrasjet në kufi cenuan dhe shkelën drejtpërdrejt të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të sanksionuara në konventa dhe akte të tjera ndërkombëtare për emigrantët.

Mosdorëzimi i kufomës së atij që vritej në përkjekje për të kaluar kufirin, sipas një udhëzimi i Ministrisë të Punëve të Brendshme nr. 01-90, datë 08.06.1983, pasohej nga akte të tjera dhunuese të identitetit. Trupi i dorëzohej institucioneve mjekësore për nevojat e tyre, ose varrosej në vende të caktuara me identifikimin e një numri regjistri. Ky fakt e ashpëson më tej temën dhe nxjerr në pah se ligjet gjatë regjimit komunist shërbyen si një mjet për konsolidimin e pushtetit të partisë dhe u shoqëruan thellësisht nga shkëlja e të drejtave themelore të njeriut, përfshirë dhe atë për të pasur një vendprehe.

Edhe disa ndryshime në Kodin Penal, në 8 maj të vitit 1990, për kalimin e paligjshëm të kufirit, nuk u shoqëruan me asnjë urdhër për ndalimin e hapjes së zjarrit nga Ministria e Brendshme. Akuza për “tradhti ndaj atdheut” në rast kalimi të paligjshëm të kufirit ra” dhe shumë shqiptarë, në kulmin e varfërisë, izolimit, shtypjes dhe me një etje te madhe për liri, tek tentuan arratisjen, gjetën sërish vdekjen,” – theksoi kreu i AIDSSH-s.

Gjatë punës së saj AIDSSH ka vërejtur se nga 311 kërkesa të familjarëve në Drejtorinë e Procesit të Identifikimit dhe Ripërkujtimin të Personave të Zhdukur, pranë AIDSSH, 10 për qind të rasteve janë kërkesa të vrasjeve në kufi. Në Drejtorinë e Informacionit numërohen rreth 126 kërkesa individuale që lidhen me tentativat për arratisje, të vrarët në kufi dhe arratisje të realizuara.

Statistikat paraprake të përpunuara nga të dhënat e dokumente arkivore tregojnë se për kufirin juglindor të vendit deri tani janë raportuar gjatë viteve 1944-1980, 45 persona të vrarë në kufi; 58 të arrestuar në tentativë për arratisje; 1054 që ja kanë dalë të arratisen; 13 të arrestuar, pas kthimit nga arratisja dhe 10 persona të pushkatuar, pas arratisjes.

Procesi i mbledhjes së të dhënave vijon me hulumtimin e dokumenteve të reja arkivore që janë deklasifikuar së fundmi. Sipas statistikave nga 9000 të arratisur gjithsej, 1000 i takojnë rrethit të Korçës Ersekës, Pogradecit në shifra, apo 11.1% e arratisjeve.”





Më tej, Kryetarja e Autoritetit tha se në kuadër të misionit të institucionit për mësimin nga e kaluara përmes realizimit të botimeve për nxënësit e shkollave 9-vjeçare, është realizuar libri për fëmijë “Kufij të thyer” ndërsa është planifikuar ndërtimi i memorialit “Shtegut të Lirisë”, i cili është ambicioz dhe pritet të bashkojë AIDSSH-n, pushtetin lokal të zonës juglindore të vendit dhe partnerët për t’u finalizuar.

E pranishme në këtë simpoziom, znj.Frédérique HANOTIER, zyrtare e Delegacionit të Bashkimit European në Shqipëri shprehu mbështetjen për misionin e AIDSSH-së në drejtim të qartësimit të fatit të të zhdukurve: “Mësimi nga e kaluara fuqizon qytetarët që të ndërtojnë një shoqëri më të qëndrueshme dhe demokratike. Kjo është një çështje komplekse dhe BE vazhdon të ketë një përkushtim të fortë për të mbështetur Shqipërinë që të merret me të shkuarën dhe të rrisë kohezionin social në kontekstin e anëtarësimit të vendit në BE.”

Simpoziomi u përshëndet nga nënkryetarja e Bashkisë së Pogradecit, znj. Entela Gusho, e cila vlerësoi zhvillimin e një simpoziomi me një tematikë kaq të ndjeshme, 80 vjet pas mbarimit të luftës dhe fillimit të historive fatkeqe që solli mbyllja e kufijve dhe ndalimi i lëvizjes. Kryetari i Shoqatës Antikomuniste, z. Et’hem Fezollari vlerësoi bashkëpunimin me Autoritetin për trajtimin e çështjeve themelore që kanë të bëjnë me ish-të përndjekurit politikë me synimin edukimin e shoqërisë me ngjarje të shkuarës që vijojnë të lenë kujtime tragjike në memorien e familjeve që kaluan në këto përvoja të dhimbshme.

Përfaqësuesi i Komisionit Ndërkombëtar të Personave të Zhdukur (Commission on Missing Persons (ICMP), Luigj Mila, bashkëpunëtor i AIDSSH-së në hartimin e databazës së personave të zhdukur dhe familjarëve të tyre gjithashtu vlerësoi rëndësinë e mbajtjes së këtij simpoziomi.

Tematikat e programuara mbi Kufijtë e Diktaturës, Kuadri Ligjor dhe Institucional në Shqipërinë Komuniste ishin në fokus të studiuësve. Prof. Asoc. Enriketa Papa, nga Departamenti i Historisë në Fakultetin e Histori-Filologjisë, Tiranë, solli një qasje analitike mbi kufirin dhe simbolikën e tij në autoritarizmin shqiptar, të krijuar nga Enver Hoxha, në Shqipërinë komuniste, duke u fokusuar tek izolimi ekstrem dhe politikën kufitare dhe nevojën së shoqërisë dhe politikës vendase në përballje me të shkuarën.

Nëpërmjet hulumtimit, analizimit të dokumenteve origjinale dhe shqyrtimi i fakteve, analizës së kuadrit ligjor AIDSSH synon të hedh dritë mbi dukuritë tragjike që solli mbyllja e kufijve dhe izolimi si: vrasjet në kufi, dënimet e gjata apo me vdekje për të arrestuarit në tentativë, pasojat me internimin kolektiv të familjes së mbetur.

Evidentimi, por dhe ekspozimi i të vërtetave historike, nxit rishqyrtimin e historisë dhe edukimin mbi të. Nga ky simpoziom, AIDSSH do të shtrojë rrugën për të hulumtuar më tej edhe në zonat të tjera kufitare të vendit, nga ku raportohen kalimet e ndaluara të kufirit si nga liqeni i Shkodrës, pika kufitare e Hanit të Hotit, Konispoli etj.





AUTORITETI PER INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TE SHTETIT

Adresa: Njësia Administrative nr. 4
Rruga e Dibrës, garnizoni "Skënderbej", Tiranë